



Partia Demokratike

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Nr. 130 prot.

Tiranë, më: 08.04.2026

UDHËZIM

Nr. 4, datë 08.04.2026

MBI ANGAZHIMIN E STRUKTURAVE TË PD NË DISKUTIMET E REFORMËS ADMINISTRATIVE DHE TERRITORIALE NË ÇDO QARK

Ky udhëzim ka për objekt angazhimin e strukturave të Partisë Demokratike, në bashkëpunim me ekspertët hartimin i një ndarjeje territoriale sa më pranë qytetarëve, duke u bazuar në njohjen e tyre mbi interesat vendore.

Strukturat e Partisë Demokratike do të zhvillojnë dëgjesa me komunitetet vendore sipas një grafiku të caktuar nga Komisioni Parlamentar i Reformës Administrative-Territoriale.

Në këtë kuadër, kërkohet angazhim dhe pjesëmarrje aktive nga degët e PD, përfshirë demokratë, këshilltarë vendorë dhe ekspertë nga radhët e opozitës.

Paraqitja e një harte të re të njësive vendore sa më pranë qytetarëve është politikisht e rëndësishme, për këtë,

UDHËZOJ:

1. Të organizohet mbledhja e kryesisë së të gjitha degëve brenda datës 15 Prill;
2. Në këtë mbledhje të shqyrtohet dhe finalizohet varianti më i pranueshëm i ndarjes territoriale që i përket njësisë përkatëse vendore;
3. T'i jepet përgjigje pyetjeve të Anketës Politike të përcjellë tek ju lidhur me ndarjen e re të bashkive, funksionimin e këshillave bashkiake dhe të qarqeve, si dhe për njësitë administrative dhe administratorët;
4. Në këtë takim të thirren për konsultim edhe individë të zgjedhur, kryetarë e këshilltarë të njësive vendore të PD ndër vite;
5. Konkluzionet dhe raporti me shkrim të shoqërohen me pamje (foto) nga diskutimet në mbledhjet e kryesisë;
6. Data e raportimit do të jetë 20 Prill;

7. Për çdo takim do të informoheni nga Sekretariati Organizativ i PDSH;
8. Njoftime më të hollësishme dhe propozimet që do të keni, do t'i përcillni në sekretariatit e qeverisjes vendore të PD në email: amiv.agency@gmail.com

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Flamur NOKA

